



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.123, datë 28.09.2020

“PËR

MIRATIMIN E TREGUESVE EKONOMIKË DHE FINANCIARË TË BASHKISË SË TIRANËS DHE TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PËR PERIUDHËN 2021-2023”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b” dhe nënpika 1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 41, pika 1 dhe pika 2 shkronja “d”, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Akti Normativ nr. 17, datë 22.04.2020 “Për përjashtimin e zbatimit të procedurave dhe të afateve për përgatitjen e projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm për vitin 2020”; udhëzimi nr. 10, datë 28.02.2020 të Ministrit Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”; vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, i ndryshuar; Vendimit nr. 158 datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2021-2023, sipas lidhjes nr. 1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2021-2023, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese, sipas lidhjes nr. 2 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njërive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe të gjitha Strukturat dhe Institucionet në varësi të Bashkisë së Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU